



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE  
TË HEKURUDHAVE TË KOSOVËS - TRAINKOS, SH.A PËR VITIN  
2020

Prishtinë, Maj 2021

## PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Çështjet e zgjidhura gjatë procesit të auditimit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Pasqyrat financiare vjetore të audituara

### Shënim

Ky Raport i auditimit është gjeneruar për herë të parë përmes platformës elektronike për menaxhimin e auditimit (SITA). Po ashtu, këtë vit, përdoret shablloni i ri i Raportit të auditimit, sipas metodologjisë së përditësuar për auditime financiare dhe të pajtueshmërisë. Raporti përfshinë për herë të parë edhe konkluzionin e veçantë për pajtueshmëri.

Jemi plotësisht të vetëdijshëm që aplikimi i të gjitha këtyre risive njëkohësisht, në rrethana të pazakonshme të pandemisë, mund të rezultojë me ndonjë lëshim të paqëllimshëm, për çka ju kërkohet falje paraprakisht dhe ju falënderojmë për mirëkuptim!

Për: Artane Rizvanolli, Ministre e Ekonomisë

Ramush Ahmetaj, Kyesues i Bordit

Gelor Shala, Kryeshef Ekzekutiv

Durim Krasniqi, Zyrtar Kryesor Financiar

Adresa: Sheshi i Lirisë p.n, Fushë Kosovë, Republika e Kosovës

## 1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Hekurudhave të Kosovës - TrainKos, sh.a për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2020, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.<sup>1</sup>

### **Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore**

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Hekurudhave të Kosovës - TrainKos, sh.a (Trainkos sh.a), të cilat përmbajnë pasqyrën e pozitës financiare për vitin 2020, pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e rrjedhës së parasë së gatshme, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet, shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme kontabël, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020.

Sipas opinionit tonë, përveç efekteve të çështjes së përshkruar në paragrafin Baza për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare të bashkangjitura për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale të pozitës financiare të Hekurudhave të Kosovës - TrainKos, sh.a deri me 31 dhjetor 2020, performancës së saj, si dhe rrjedhës së parasë së gatshme për vitin 2020, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

**Baza për Opinion të Kualifikuar**

- A1 Llogaritë e pagueshme tregtare janë detyrime që krijohen gjatë kryerjes së aktiviteteve kryesore të njësisë ekonomike. Ato krijohen si pasojë e blerjes së mallrave apo shërbimeve me pagesë të mëvonshme. Llogaritë e pagueshme tregtare janë të mbivlerësuara për 38,949€ për faktin që nuk ka dëshmi që e arsyeton detyrimin ndaj furnitorëve me fatura apo kontrata.
- A2 Në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, zëri i shpenzimeve tjera që përfaqëson shpenzimet e zhvlerësimit ishte prezantuar me vlerë prej 1,112,854€. Prej tyre, vlera prej 10,333€ ishte njohur nga ndërmarrja si shpenzime të zhvlerësimit nga grantet të cilat janë thyer me të hyrat e shtyra nga granti. Gjatë auditimit ne identifikuam se këto shpenzime nuk janë bërë për investime siç ka qenë dedikimi i grantit por për shpenzime operative - materiale hargjuese pra, jashtë natyrës së dedikimit. Rrjedhimisht të hyrat e shtyra nga granti janë mbivlerësuar në PFV për këtë vlerë.
- B1 Trainkos në Pasqyrën e pozitës financiare ka prezantuar pasuri jo qarkulluese (prona, pajisje dhe impiante) në vlerë neto 3,592,240€. Trainkos nuk kishte bërë rivlerësimin e pasurive që nga viti 2007. Andaj në mungesë të rivlerësimit sipas kërkesave të SNK 16 ne nuk ishim në gjendje të konstatojmë se vlerat e pasurive ishin të sakta, të plota dhe të paraqitura me besueshmëri në PFV.

*Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'.

Në përputhje me ONISA-P-10 dhe SNISA 130, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të Ndërmarrjeve Publike, Kodin e Etikës të ZKA-së, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin.

**Konkluzion për pajtueshmërinë**

Ne kemi audituar gjithashtu pajtueshmërinë e menaxhmentit të Hekurudhave të Kosovës - TrainKos, sh.a me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjeve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të kualifikuar, transaksionet e kryera të Hekurudhave të Kosovës - TrainKos, sh.a kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

**Baza për konkluzion**

B2 Gjatë auditimit kemi vërtetuar se ndërmarrja nuk kishte paguar brenda afatit kohor prej 30 ditësh klientit/Infrakos sh.a faturat në vlerë 613,109€ të cilat i kishte pranuar nga muaji janar deri dhjetor 2020. Këto fatura ishin raportuar si detyrim në PFV e vitit 2020. Më tej, testet tona për 30 mostra në shumën 24,636€, tregojnë se kishte vonesa për shlyerjen e detyrimeve ndaj furnitorëve me disa muaj madje në 19 raste më shumë se një vit.

*Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'.

Në përputhje me ONISA-P-10 dhe SNISA 130, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të Ndërmarrjeve Publike, Kodin e Etikës të ZKA-së, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

**Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore**

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). Po ashtu, menaxhmenti është përgjegjës për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa keqdeklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë gjithashtu zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime), Ligjit nr. 04/L-087 për Ndërmarrjet Publike (me plotësime dhe ndryshime), Ligjit 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim

Bordi i Drejtorëve është përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Hekurudhave të Kosovës - TrainKos, sh.a.

**Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë**

Menaxhmenti i Hekurudhave të Kosovës - TrainKos, sh.a është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Hekurudhave të Kosovës - TrainKos, sh.a në përputhje me Ligjin për Ndërmarrjet Publike, si dhe të gjitha ligjet, rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.<sup>2</sup>

## Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të marrim siguri të arsyeshme se Pasqyrat Financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të nxjerrim një raport të auditimit që përfshinë opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është niveli i lartë sigurie, por nuk garanton se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keqdeklarim material që mund të ekzistojë. Keqdeklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, me arsye pritet që të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra në bazë të këtyre Pasqyrave Financiare.

Objekivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Hekurudhat e Kosovës - TrainKos, sh.a me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare. Si pjesë e auditimit, në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-t, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keqdeklarimit material të Pasqyrave Financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit; hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit konform atyre rreziqeve, si dhe sigurojmë dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të duhura për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i moszbulimit të një keqdeklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për keqdeklarimin që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulimin, falsifikimin, lëshime të qëllimshme, keqpërfaqësime apo anashkalimin e kontrollit të brendshëm.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme në rrethanat, por jo me qëllim të shprehjes së opinionit për efikasitet të kontrollit të brendshëm të Hekurudhave të Kosovës - TrainKos, sh.a.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të përdorura kontabël dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet përkatëse të bëra nga menaxhmenti.
- Nxjerrim një përfundim nëse baza e vijimësisë së kontabilitetit është e përshtatshme për përdorim nga menaxhmenti, bazuar në provat e siguruar të

auditimit, nëse ekziston pasiguria materiale në lidhje me ngjarje apo kushte që mund të hedhin dyshime të rëndësishme në aftësinë e Hekurudhave të Kosovës - TrainKos, sh.a, për të vazhduar sipas parimit të vijimësisë. Nëse konkludojmë se ekziston një pasiguri materiale, nga ne kërkohet që të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për shpalosjet përkatëse në Pasqyrat Financiare ose, nëse zbulimet e tilla janë të papërshtatshme ta modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona bazohen në provat e auditimit të marra deri në datën e raportit tonë të auditimit. Sidoqoftë, ngjarjet apo kushtet e ardhshme mund të bëjnë që NP-ja të pushojë së vazhduari sipas parimit të vijimësisë.

- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e Pasqyrave Financiare, përfshirë edhe shpalosjet, për t'u siguruar se Pasqyrat Financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në mënyrë të drejtë dhe të saktë.


Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuara me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKAsë, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si sensitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

## 2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve (siç janë paraqitur në Grafikonin 1, më poshtë) dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Grafiku 1. Lloji i gjetjeve sipas kategorive ekonomike<sup>3</sup>



Ne po ashtu, kemi rishikuar statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe kemi vlerësuar nivelin e zbatimit të tyre. [Për detajet shih kapitullin ].



## 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

### Çështja A1 - Mungesa e dokumenteve burimore për të pagueshmet

#### Gjetja

Sipas SNK 1 një njësi ekonomike duhet të japë informacion shpjegues, ose në pasqyrën e pozicionit financiar ose në shënimet shpjeguese, për nën klasifikime të mëtejshme të zërave të paraqitur, të klasifikuar në një mënyrë të përshtatshme për operacionet e njësisë ekonomike. Të dhënat e kontabilitetit duhet të jenë burim i besueshëm për hartimin e pasqyrave financiare.

Llogaritë e pagueshme tregtare janë detyrime që krijohen gjatë kryerjes së aktiviteteve kryesore të njësisë ekonomike. Ato krijohen si pasojë e blerjes së mallrave apo shërbimeve me pagesë të mëvonshme. Llogaritë e pagueshme tregtare janë mbivlerësuar për 38,949€ për faktin që nuk ka dëshmi që e arsyeton detyrimin ndaj furnitorëve me fatura apo kontrata. Kjo shumë i takon disa furnitorëve të cilët ishin evidentuar nga raporti i ndarjes mes Trainkos dhe Infrakos nga viti 2011.

Shkak i paraqitjes së këtyre detyrimeve ndaj furnitorëve në PFV për shumë vite me radhë është mungesa e rishikimeve dhe vlerësimeve periodike nga menaxhmenti për t'u siguruar se për këto detyrime ekziston dokumentacion i besueshëm ose për ti shlyer nëse vërtetohet se nuk ka obligime mbi to.

#### Ndikimi

Mungesa e kontrolleve adekuate në sistemin e kontabilitetit si dhe mos harmonizimi periodik i të dhënave të ndërmarrjes dhe furnitorëve ndikon në prezantimin jo të drejtë të informatave në pasqyra financiare.

#### Rekomandimi A1

Bordi i drejtorëve duhet të sigurojë se janë marrë veprimet e nevojshme për harmonizimin e të dhënave ndërmjet ndërmarrjes dhe furnitorëve të saj në baza periodike në mënyrë që të sigurohet informacioni i saktë i vlerës së llogarive të pagueshme. Ndërsa për detyrime që janë me të vjetra se 10 vite të trajtohen në pajtim me Ligjin nr. 03/L-154 për pronësinë dhe të drejtat sendore.

### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### Çështja A2 - Mbivlerësimi i të hyrave të shtyra nga grantet

#### Gjetja

Sipas SNK 20 "Grantet e lidhura me aktivet janë grante qeveritare, kushti kryesor i të cilave është që njësi ekonomike përfituese të blejë, ndërtojë ose të marrë në një mënyrë tjetër aktive afatgjata". Po ashtu "Grantet qeveritare që lidhen me aktivet, përfshirë grantet jo monetare me vlerë të drejtë, duhet të paraqiten në pasqyrën e pozicionit financiar ose duke e njohur grantin si të ardhur të shtyrë ose duke zbritur grantin që merret nga vlera e mbartur e aktivit".

Në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, zëri i shpenzimeve tjera që përfaqëson shpenzimet e zhvlerësimit ishte prezantuar me vlerë prej 1,112,854€, ku prej tyre vlera prej 10,333€ ishte njohur nga ndërmarrja si shpenzime të zhvlerësimit nga grantet dhe janë thyer me të hyrat e shtyra nga granti. Gjatë auditimit ne identifikuam se këto shpenzime nuk janë bërë për investime siç ka qenë dedikimi i grantit, por për shpenzime operative - materiale harxhuese, pra jashtë natyrës së dedikimit. Për këtë vlerë të hyrat e shtyra nga granti janë mbivlerësuar në PFV.

Kjo kishte ndodhur për shkak se menaxhmenti nuk kishte bërë gjykim të drejtë të njohjes së të ardhurave të shtyra nga grantet, por gabimisht kishte ngarkuar në këtë zë edhe shpenzimet për materiale hargjuese jashtë dedikimit të grantit.

**Ndikimi** Mos trajtimi adekuat në kontabilitet i të ardhurave të shtyra nga grantet, ndikon në prezantimin jo të drejtë të informatave në pasqyra financiare.

**Rekomandimi A2** Bordi i drejtorëve duhet të sigurojë se janë marrë veprimet e nevojshme për të aplikuar drejtë metodologjinë e trajtimit dhe njohjes së të ardhurave nga grantet dhe të zhvlerësimit të tyre në kontabilitet dhe në PFV.

### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

### **Çështja B1 - Mungesa e rivlerësimit të pasurive jo qarkulluese**

**Gjetja** Sipas Standardit Ndërkombëtar të Kontabilitetit - SNK 16, rivlerësimi i pasurive jo qarkulluese kërkohet të bëhen çdo tre deri në pesë vjet. Kjo bëhet në mënyrë që njësia ekonomike të sigurohet se vlera kontabël (neto) e aktivit nuk ndryshon materialisht nga ajo që do të përcaktohej nëse do të përdorej vlera e drejtë në fund të periudhës raportuese.

Trainkos në Pasqyrën e pozitës financiare ka prezantuar pasuri jo qarkulluese (prona, pajisje dhe impiante) në vlerë neto 3,592,240€. Trainkos nuk kishte bërë rivlerësimin e pasurive që nga viti 2007. Andaj në mungesë të rivlerësimit sipas kërkesave të SNK 16 ne nuk ishim në gjendje për të konstatuar se vlerat e pasurive ishin të sakta, të plota dhe të paraqitura me besueshmëri në PFV.

Çështja e rivlerësimit të pasurive jo qarkulluese, ishte trajtuar edhe në raportin e auditimit financiar për vitin 2019. Në vitin 2020 Trainkos kishte filluar një procedurë për të kontraktuar një kompani e cila do të bënte rivlerësimin, mirëpo nuk kishte arritur ta finalizoj këtë procedurë deri në fund të vitit 2020.

**Ndikimi** Mungesa e rivlerësimit të pasurive të cilat janë në pronësi dhe në regjistrat e ndërmarrjes, ndikon në paraqitjen jo të drejtë të pasurisë në PFV.

**Rekomandimi B1** Bordi i drejtorëve të sigurojë një rishikim gjithëpërfshirës të regjistrit të pasurisë dhe të ndërmarrë veprime konkrete për rivlerësimin dhe rishikimin e jetës së dobishme të pasurive së paku një herë në (5) pesë vite. Kjo me qëllim të paraqitjes së vlerës reale të pasurive, në përputhje me kërkesat e SNK 16.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

### Çështja B2 - Mos pagimi i faturave brenda afatit të kontraktuar

**Gjetja** Paragrafi 13 i marrëveshjes së lidhur ndërmjet Trainkos dhe Infracos sh.a për ofrimin e shërbimeve të përbashkëta dhe pagesën e tyre, përkufizon se pagesat e faturave të papaguara duhet të bëhen më së largu brenda 30 ditëve nga dita e pranimin të faturave të protokolluara nga arkivat përgjegjëse të të dy ndërmarrjeve. Po ashtu kjo rregull vlen edhe në kontratat e nënshkruara nga ndërmarrja me furnitorët tjerë.

Gjatë auditimit kemi vërtetuar se ndërmarrja nuk kishte paguar brenda afatit kohor prej 30 ditësh klientit/Infracos sh.a faturat në vlerë 613,109€ të cilat i kishte pranuar nga muaji janar deri dhjetor 2020. Këto fatura ishin raportuar si detyrim në PFV e vitit 2020. Më tej, testet tona për 30 mostra në shumën 24,636€, tregojnë se kishte vonesa për shlyerjen e detyrimeve ndaj furnitorëve me disa muaj madje në 19 raste më shumë se një vit.

Sipas zyrtarëve përgjegjës kjo kishte ndodhur për shkak të buxhetit të pamjaftueshëm për të shlyer këto detyrime dhe kjo ka bërë që detyrimet ndaj furnitorëve të rriten gjatë viti 2020. Mirëpo në datën raportuese të PFV, më 31.12.2020 gjendja e parasë së gatshme në xhirollogarinë e ndërmarrjes ishte 428,591€, pra një saldo e mjaftueshme për të shlyer një pjesë të këtyre detyrimeve.

**Ndikmi** Mos pagesa e faturave ndaj operatorëve ekonomik brenda afateve të përcaktuara rrit mundësinë e padive, apo shlyerjes së borxhit përmes përmbauesve privat e cila mund të shkaktoj kosto shtesë për ndërmarrjen.

**Rekomandimi B2** Bordi i drejtorëve të sigurojë krijimin e një mekanizmi të kontrollit që monitoron të gjitha detyrimet ndaj operatorëve ekonomik në mënyrë që faturat të paguhen brenda afateve kohore të përcaktuara në kushtet me kontratën në mes të dy palëve.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.3 Gjetjet për çështjet e kontabilitetit dhe të pajtueshmërisë

### 2.3.1 Llogaritë e arkëtueshme

Vlera e llogarive të arkëtueshme, e prezantuar në PFV ishte 1,160,640€. Ato kanë të bëjnë me arkëtimet ndaj klientëve nga afarizmi i rregullt i ndërmarrjes. Ne kemi testuar 22 mostra për teste substanciale në vlerë 1,160,640€.

#### **Çështja B3 - Mos barazimi i evidencave kontabël dhe letër konfirmimeve për të arkëtueshmet**

##### **Gjetja**

Sipas SNK 1 një njësi ekonomike duhet të japë informacion shpjegues, ose në pasqyrën e pozicionit financiar ose në shënimet shpjeguese, për nën klasifikime të mëtejshme të zërave të paraqitur, të klasifikuar në një mënyrë të përshtatshme për operacionet e njësisë ekonomike. Të dhënat e kontabilitetit duhet të jenë burim i besueshëm për hartimin e pasqyrave financiare.

Për të testuar saktësinë e llogarive të arkëtueshme tregtare, përveç procedurave tjera, ne kemi dërguar 13 letër konfirmime te palët e treta/klientët në vlerë të përbashkët prej 986,602€, ndërsa prej tyre ne kemi pranuar vetëm katër (4) letër konfirmime me vlerë prej 750,383€. Prej tyre, njëra ka rezultuar me nënvlerësim të kartelës së klientit në vlerë prej 5,565€.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mos harmonizimit të kartelave në mes të klientëve dhe ndërmarrjes.

##### **Ndikimi**

Mungesa e kontrolleve adekuate në sistemin e kontabilitetit si dhe mos harmonizimi periodik i të dhënave të ndërmarrjes dhe klientëve të saj ndikon në prezantimin jo të drejtë të informatave në pasqyra financiare.

##### **Rekomandimi B3**

Bordi i drejtorëve duhet të sigurojë se janë marrë veprimet e nevojshme për harmonizimin e të dhënave ndërmjet ndërmarrjes dhe klientëve të saj në baza periodike në mënyrë që të sigurohet informacioni i saktë i vlerës së llogarive të arkëtueshme.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.3.2 Parapagimet

Në pasqyrën e pozitës financiare është prezantuar zëri pasuritë tjera afatshkurtra me vlerë prej 434,753€, në këtë zë përveç të tjerave është përfshirë edhe vlera prej 21,250€ e parapagimeve (avanset e dhëna). Ne kemi testuar 5 mostra nga kjo kategori dhe rezultatet e testimit kanë rezultuar si vijon:

### Çështja B4 - Parapagimet e periudhave të mëhershme

**Gjetja** Sipas SNK 1 shpenzimet e parapaguara shfaqen atëherë kur paguhet para para se të përdoret artikulli, shërbimi apo dobia, ndërsa shpenzimet përkatëse njihen gjatë periudhës përkatëse të pranimit të tyre.

Në pasqyrën e pozitës financiare është prezantuar zëri pasuritë tjera afatshkurtra me vlerë prej 434,753€, në të cilin janë përfshirë edhe vlera prej 21,250€ e parapagimeve (avanset e dhëna). Ne kërkuam informata nga zyrtarët e ndërmarrjes për të vërtetuar të drejtat dhe detyrimet ndaj kësaj vlere, por vërejtëm se pas regjistrimeve në sistemin e kontabilitetit nuk ka dokumentacion faktik e as informacion kredibil i cili tregon se ekzistojnë të drejta të ndërmarrjes ndaj furnitorëve të caktuar apo palëve kontraktuale tjera.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mos rishikimit periodik të informacioneve financiare në sistemin e kontabilitetit dhe harmonizimit të shënimeve të ndërmarrjes me furnitorët respektiv për t'i identifikuar dhe trajtuar këto pasuri.

**Ndikimi** Mungesa e kontrolleve efektive në trajtimin e parapagimeve si dhe mungesa e evidencave të cilat e konstatojnë të drejtën e ndërmarrjes mbi to, ndikon në prezantimin jo të drejtë të tyre në pasqyrën e pozitës financiare.

**Rekomandimi B4** Bordi i drejtorëve të sigurojë se ekzistojnë dëshmi valide dhe kredibile për të konfirmuar të drejtat e ndërmarrjes për këto parapagime. Në të kundërtën në qoftë se nuk konstatohen të drejtat e ndërmarrjes për këta furnitorë të sigurojë se janë larguar nga regjistri i parapagimeve të ndërmarrjes.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

### 2.3.3 Detyrimet afatshkurta

Vlera neto e zërit të Llogarive te pagueshme tregtare e prezantuar në PFV ishte 782,010€. Ne kemi testuar 60 mostra për teste substanciale në vlerë 781,336€.

#### Çështja A3 - Mos barazimi i evidencave kontabël dhe letër konfirmimeve për të pagueshmet

##### Gjetja

Sipas Kornizës Konceptuale për raportim financiar, paragrafi 4.26, një detyrim njihet në pasqyrën e pozicionit financiar kur ka gjasa që burime ekonomike të dalin nga njësia ekonomike për të shlyer një detyrim aktual dhe shuma me të cilën do të shlyhet detyrimi mund të matet me besueshmëri.

Për të testuar saktësinë e llogarive të pagueshme tregtare, përveç procedurave tjera, ne kemi dërguar 23 letër konfirmime te palët e treta/furnitorët me vlerë të përbashkët prej 772,891€. Deri në përfundim të auditimit kemi pranuar vetëm 10 letër konfirmime me vlerë të përbashkët prej 717,782€, prej të cilave një (1) ka rezultuar me mbi deklaram të kartelës së furnitorit në vlerë prej 4,240€, kurse për dy (2) të tjera janë nën deklaruar për 759€.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mos harmonizimit të kartelave në mes të furnitorëve dhe ndërmarrjes.

##### Ndikimi

Mungesa e kontrolleve adekuate në sistemin e kontabilitetit si dhe mos harmonizimi periodik i të dhënave të ndërmarrjes dhe furnitorëve ndikon në prezantim jo të drejtë të informatave në pasqyra financiare.

##### Rekomandimi A3

Bordi i drejtorëve duhet të sigurojë se janë marrë veprimet e nevojshme për harmonizimin periodik të kartelave financiare mes ndërmarrjes dhe furnitorëve në mënyrë që të këtë pasqyrë sa më të qartë për detyrimet e saj ndaj furnitorëve.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

## 2.3.4 Të hyrat

Vlera e paraqitur në PFV-të e të hyrave operative është 715,284€, Ne kemi testuar 56 mostra për teste substanciale në vlerë 77,959€, si dhe 5 mostra për teste të pajtueshmërisë.

### Çështja B5 - Ofrimi i shërbimeve (shitja e naftës) jashtë fushëveprimit dhe aktiviteteve të ndërmarrjes

**Gjetja** Trainkos me statut ka të përcaktuara aktivitetet e saj prej të cilave gjeneron të hyra, si në vijim: menaxhimi, operimi dhe ofrimi i shërbimeve për transportin e udhëtarëve dhe mallrave, si dhe ofrimi i shërbimeve të mirëmbajtjes dhe renovimit të të gjitha mjeteve lëvizëse për institucionet tjera jashtë hekurudhës.

Trainkos gjatë vitit 2020, ka realizuar të hyra tjera duke shitur naftë ndërmarrjes publike Infrakos sh.a në shumë prej 18,854€. Këto të hyra Trainkos i kishte realizuar jashtë kornizës statutore të saj. Trainkos-i naftën ia shet ndërmarrjes publike Infrakos sh.a me çmim të furnizimit pa aplikuar ndonjë tarifë shtesë për kostot e ruajtjes, magazinimit dhe sigurimit në rezervuarët e saj.

Shitjen e naftës Trainkos e kishte bërë duke u bazuar në marrëveshjen për shërbime të përbashkëta mes Trainkos dhe Infrakos sh.a të datës 16.04.2019.

**Ndikimi** Zhvillimi i aktiviteteve të pa përfshira në statut dhe pa ndonjë përfitim ekonomik ndikojnë në zvogëlimin e vëmendjes në fushat kryesore ku gjenerohen të hyrat dhe në kosto shtesë të panevojshme. Për më tepër gjenerimi i të hyrave jashtë mandatit statutor rrezikon ndërmarrjen të sanksionohet nga autoritetet kompetente për mbikëqyrjen e tregut.

**Rekomandimi B5** Bordi i drejtorëve të siguroj se ofrimi i shërbimeve bëhet vetëm për ato veprimtari të cilat janë të përcaktuara me statut dhe të ndërmarr masat e duhura për ndërprerjen e shitjes së naftës te palët tjera. Po ashtu, të rishikojë marrëveshjen me Infrakos sh.a. duke i përjashtuar të gjitha ato punë dhe shërbime që mund të ofrohen direkt nga operatorët tjerë ekonomik dhe që nuk janë veprimtari statutore e ndërmarrjes.

### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)



### 2.3.5 Çështjet e ndërlidhura me shpenzimet për menaxhimin e pandemisë Covid -19

Trainkos gjatë vitit 2020 kishte pranuar subvencion nga pakoja emergjente me vendim të qeverisë për menaxhimin e situatës së krijuar nga pandemia Covid-19 në vlerë prej 600,000€. Nga kjo shumë 500,000€ ishin dedikuar për të shlyer detyrimet ndaj furnitorëve respektivisht Infrakos sh.a, gjersa pjesa tjetër prej 100,000€ ishte akorduar për të mbuluar deficitin në shpenzime tjera, respektivisht ishin paguar për: detyrimet e papaguara të kontributeve në paga në vlerë të përbashkët prej 69,080€, për shpenzimet e furnizimit me naftë në vlerë prej 30,460€, si dhe shpenzime për shpenzime administrative prej 460€.

#### Çështja A4 - Dhënia e stimulimeve për punonjës pa miratim nga bordi

- Gjetja** Rregullorja mbi pagat dhe kompensimet tjera në Trainkos sh.a nr. 985, neni 26.1 thotë se " Të punësuarve në Trainkos me vendim të Kryeshefit Ekzekutiv dhe me pajtim të Bordit të Drejtorëve mund t'u takojnë kompensime të veçanta të cilat nuk janë obligative sipas legjislacionit në fuqi (pagesa e përvojës së punës, pagesa e shujtës ditore, pagesa e shpenzimeve të udhëtimit, mëditje të ndryshime për stafin ekzekutiv, etj) ".
- Stimulimet në pagën bruto ishin dhënë bazuar në rekomandimin e komisionit të posaçëm për menaxhimin e pandemisë COVID -19 për të stimuluar punonjësit të paraqiten në punë në kohën e masave kufizuese me qëllim të mbrojtjes nga pandemia.
- Ndikimi** Dhënia e stimuljeve pa miratim nga Bordi i drejtorëve, përveç se është në kundërshtim me rregulloren, rrit rrezikun që procesi të mos jetë i drejtë, duke shkaktuar kështu diskriminim dhe pakënaqësi brenda ndërmarrjes e cila si pasojë mund të ketë ndikim në mos realizimin e objektivave. Poashtu krijohen shpenzime të paparashikueshme që mund të rëndojnë gjendjen financiare të ndërmarrjes.
- Rekomandimi A4** Bordi i drejtorëve të siguroj se stimujt e veçantë të jepen vetëm në bazë të procedurës zyrtare të miratuar nga Bordi, e cila do të duhej të siguronte transparencë dhe trajtim të barabartë për të gjithë punonjësit e ndërmarrjes.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### 3 Çështjet e zgjidhura gjatë procesit të auditimit

Gjatë auditimit u identifikua një çështje që iu komunikua menaxhmentit dhe u zgjidh në mënyrë efektive gjatë auditimit aktual. Kjo çështje nuk kërkon ndonjë veprim të mëtejshëm dhe raportohet vetëm me qëllim të dokumentimit të komunikimit në fjalë, veprimet të ndërmarrë dhe rezultateve të saj. Çështja e evidentuar dhe përmirësuar ishte si më poshtë.

Çështja jo materiale të cilën ne e kemi identifikuar dhe është përmirësuar gjatë kohës së auditimit


- Gjatë procesit të auditimit për vitin 2020, kemi vërejtur mangësi në listën e pagave të deklaruara në sistemin elektronik të Administratës Tatimore të Kosovës. Në listën e pagave 15 punonjës ishin deklaruar dy herë për 12 muaj të vitit 2020, ku përfshihet tatimi në pagë dhe kontributi pensional. Ndërsa 15 punonjës tjerë të Trainkos-it nuk ishin përfshirë fare në listën e pagave për deklarim të tatimeve dhe kontributeve pensionale. Trainkos ka arritur të bëjë korrigjimin e deklarimeve në ATK për tatimet dhe kontributet e punonjësve të vitit 2020. Ky korrigjim ka ndodhur gjatë procesit të auditimit për PFV-të e vitit 2020.

## 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2019 të Trainkos sh.a ka rezultuar në 10 rekomandime kryesore. Ndërmarrja kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatohet rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2020, 5 rekomandime janë zbatuar dhe 5 nuk janë adresuar ende, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 1 (ose Tabelën e rekomandimeve).

**Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak**



**Tabela 1 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2020**

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2019	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Bordi i drejtorëve të sigurojë një rishikim gjithëpërfshirës të regjistrit të pasurisë dhe të ndërmarrë veprime konkrete për rivlerësimin dhe rishikimin e jetës së dobishme të pasurive së paku një herë në (5) pesë vite. Kjo me qëllim të paraqitjes së vlerës reale të pasurive, në përputhje me kërkesat e SNK 16.	Trainkos ka nisur një procedurë për vlerësimin e pasurive në 2020, mirëpo ishte anuluar.	Nuk ka filluar zbatimin
2.	Çështjet për pasqyrat financiare	Bordi i drejtorëve të sigurojë hartimin dhe miratimin e udhëzuesit të politikave dhe procedurave kontabël dhe zbatimin e tij në mbajtjen e librave kontabël dhe raportim financiar.	Është miratuar një dokument i tillë.	I zbatuar
3.	Llogaritë e arkëtueshme	Bordi i drejtorëve duhet të sigurojë se janë marrë veprimet e nevojshme për harmonizimin e të dhënave ndërmjet ndërmarrjes dhe klientëve të saj në baza periodike në mënyrë që të sigurohet informacioni i saktë i vlerës së llogarive të arkëtueshme.	Ende ka diferenca mes letër konfirmimeve dhe të dhënave të ndërmarrjes.	Nuk ka filluar zbatimin

4.	Stoqet	Bordi i drejtorëve duhet të sigurojë se bëhen barazimet e gjendjes së stoqeve në evidencat kontabël me gjendjen faktike të tyre si dhe të shtoj kontrollet për përcjelljen e gjendjes së stoqeve, në mënyrë që të sigurohet saktësia e vlerës së tyre për tu prezantuar saktë në pasqyrat financiare.	Nuk ka pasur diferenca mes regjistrimit fizik dhe evidencave kontabël.	I zbatuar
5.	Stoqet	Bordi i drejtorëve duhet të sigurojë që bëhet harmonizimi i sasisë fizike të naftës me regjistrat kontabël, për të siguruar saktësinë e vlerës së naftës, të stoqeve dhe rrjedhimisht të pasurive të prezantuar në pasqyrat financiare.	Nuk ka pasur diferenca në këtë zë mes regjistrimit fizik dhe evidencave kontabël.	I zbatuar
6.	Parapagimet	Bordi i drejtorëve të sigurojë se ekzistojnë dëshmi valide dhe kredibile për të konfirmuar të drejtat e ndërmarrjes për këto parapagime. Në të kundërtën në qoftë se nuk konstatohen të drejtat e ndërmarrjes për këta furnitorë të sigurojë se janë larguar nga regjistri i parapagimeve të ndërmarrjes.	Nuk është zbatuar. Edhe këtë vit janë bartur në PFV parapagime të cilat nuk kanë dokumente të besueshme dhe të qarta që dëshmojnë se Trainkos ka të drejta ndaj palëve të prezantuara.	Nuk ka filluar zbatim
7.	Detyrimet afatshkurta	Bordi i drejtorëve të sigurojë ndërtimin e një mekanizmi të kontrollit që monitoron të gjitha detyrimet ndaj operatorëve ekonomik dhe që paguhen brenda afateve kohore të dakorduara si në kushtet e përcaktuara të kontratës në mes dy palëve.	Nuk është zbatuar sepse ka ende fatura që nuk paguhen në afatin e përcaktuar.	Nuk ka filluar zbatim
8.	Detyrimet afatshkurta	Bordi i drejtorëve duhet të sigurojë se llogaritë e pagueshme barten dhe prezantohen me vlerën e tyre reale në pasqyrat financiare.	Është bërë përmirësimi i bazës së të dhënave tek llogaritë e pagueshme tregtare.	I zbatuar
9.	Të hyrat	Bordi i drejtorëve të siguroj se ofrimi i shërbimeve bëhet vetëm për ato veprimtari të cilat janë të përcaktuara me statut dhe të marr masat e duhura për ndërprerjen e shitjes së naftës ndaj ndërmarrjes tjetër. Po ashtu të rishikojë marrëveshjen duke i përfshirë të gjitha ato punë dhe shërbime që mund të ofrohen direkt nga operator tjerë ekonomik dhe që nuk janë veprimtari statutorë e ndërmarrjes.	Situata është e njëjtë.	Nuk ka filluar zbatim
10.	Shpenzimet operative	Bordi i drejtorëve të siguroi se për çdo kontratë publike me vlerë të madhe dhe të mesme është caktuar menaxheri i kontratës për përcjelljen e procesit të mbarëvajtjes së furnizimit, pasi të jetë nënshkruar kontrata nga të dy palët.	Është caktuar menaxheri në çdo kontratë me vlerë të mesme dhe madhe.	I zbatuar

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2020
1.	Baza për opinion	Bordi i drejtorëve duhet të sigurojë se janë marrë veprimet e nevojshme për harmonizimin e të dhënave ndërmjet ndërmarrjes dhe furnitorëve të saj në baza periodike në mënyrë që të sigurohet informacioni i saktë i vlerës së llogarive të pagueshme. Ndërsa për detyrime që janë me të vjetra se 10 vite të trajtohen në pajtim me ligjin nr. 03/L-154 për pronësinë dhe të drejtat sendore.
2..	Baza për opinion	Bordi i drejtorëve duhet të sigurojë se janë marrë veprimet e nevojshme për të aplikuar drejtë metodologjinë e trajtimit dhe njohjes së të ardhurave nga grantet dhe të zhvlerësimit të tyre në kontabilitet dhe në PVF.
3.	Baza për opinion	Bordi i drejtorëve të sigurojë një rishikim gjithëpërfshirës të regjistrit të pasurisë dhe të ndërmarrë veprime konkrete për rivlerësimin dhe rishikimin e jetës së dobishme të pasurive së paku një herë në (5) pesë vite. Kjo me qëllim të paraqitjes së vlerës reale të pasurive, në përputhje me kërkesat e SNK 16..
4.	Baza për konkluzion	Bordi i drejtorëve të sigurojë krijimin e një mekanizmi të kontrollit që monitoron të gjitha detyrimet ndaj operatorëve ekonomik në mënyrë që faturat të paguhen brenda afateve kohore të përcaktuara në kushtet me kontratën në mes të dy palëve
5.	Llogaritë e arkëtueshme	Bordi i drejtorëve duhet të sigurojë se janë marrë veprimet e nevojshme për harmonizimin e të dhënave ndërmjet ndërmarrjes dhe klientëve të saj në baza periodike në mënyrë që të sigurohet informacioni i saktë i vlerës së llogarive të arkëtueshme.
6.	Parapagimet	Bordi i drejtorëve të sigurojë se ekzistojnë dëshmi valide dhe kredibile për të konfirmuar të drejtat e ndërmarrjes për këto parapagime. Në të kundërtën në qoftë se nuk konstatohen të drejtat e ndërmarrjes për këta furnitorë të sigurojë se janë larguar nga regjistri i parapagimeve të ndërmarrjes.
7.	Detyrimet afatshkurta	Bordi i drejtorëve duhet të sigurojë se janë marrë veprimet e nevojshme për harmonizimin periodik të kartelave financiare mes ndërmarrjes dhe furnitorëve në mënyrë që të këtë pasqyrë sa më të qartë për detyrimet e saj ndaj furnitorëve.
8.	Të hyrat	Bordi i drejtorëve të siguroj se ofrimi i shërbimeve bëhet vetëm për ato veprimtari të cilat janë të përcaktuara me statut dhe të marr masat e duhura për ndërprerjen e shitjes së naftës ndaj ndërmarrjes tjetër. Po ashtu të rishikojë marrëveshjen duke i përjashtuar të gjitha ato punë dhe shërbime që mund të ofrohen direkt nga operator tjerë ekonomik dhe që nuk janë veprimtari statutore e ndërmarrjes.
9.	Covid - 19	Bordi i drejtorëve të siguroj se stimujt e veçantë të jepen vetëm në bazë të procedurës zyrtare të miratuar nga Bordi, e cila do të duhej të siguronte transparencë dhe trajtim të barabartë për të gjithë punonjësit e ndërmarrjes.

Besnik Osmani, Auditor i Përgjithshëm

Arvita Zyferi, Ndihmëse e Auditorit të Përgjithshëm

Enver Boqolli, Udhëheqës i Auditimit

Fejzullah Fejza, Udhëheqës i ekipit

Krenare Pirana, Anëtare e ekipit

Valbona Pllana, Anëtare e ekipit

## Shtojca I: Letër konfirmimi



**HEKURUDHAT E KOSOVËS TRAINKOS SH.A**

### LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2020 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e Pasqyrave Financiare të Hekurudhave të Kosovës – Trainkos sh.a, për vitin 2020 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Z. Ramush Ahmetaj

Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve,

Data: 27 maj 2021, Fushë Kosovë,



## Shënimet fundore

- <sup>1</sup> Pajtueshmëria me autoritetet – pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante.
- <sup>2</sup> Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- <sup>3</sup> Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja  
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura  
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.